

Raport mbi veprimtarinë vjetore të investimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme gjatë vitit 2020.

Referuar ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë, vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.56, datë 03.10.2017 për miratimin e rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, neni 18, pika 1, dokumentit “Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, po paraqesim informacionin lidhur me veprimtarinë vjetore investuese për portofolin e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për periudhën Janar - Dhjetor 2020 si vijon:

Në dhjetor të vitit 2019, Komiteti i Investimeve në zbatim të Politikës e Administrimit të Mjeteve Financiare, miratoi strategjinë vjetore të investimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2020.

Në mars të vitit 2020 është miratuar në Bankën e Shqipërisë, politika e re e investimit për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ndryshimet lidheshin me përcaktimin e kritereve për ti hapur rrugë ndërmjetësimit nga bankat zhvilluese të tregut në Shëipëri; përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes së institucioneve financiare të huaja për shërbimin e kujdestarisë, të ndërmjetësimit dhe tregtimit; përcaktimin e kriterit të rrezikut të kredisë për instrumentet në të cilat investohen mjetet financiare të FNJ-së.

Në vijim të shkresës së Bankës së Shqipërisë për kontributin e vitit të tretë, të gjitha bankat bënë pagesën përkatëse të kontributit për vitin e tretë, në shumën prej 654.202.247 lekë brenda afatit të pagesës dt. 30 prill 2020.

Mjetet financiare të disponueshme në Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2020 arrijnë vlerën prej 1,992 milion lekë duke pasur një rritje prej 52,48% krahasuar me një vit më parë. Duke ditur se arkëtimi i kontributit ndodh në një periudhë kohore disa ditore, për të patur një portofol me maturitete të përshkallëzuara është përdorur instrumenti i depozitës një javore pranë

Bankës së Shqipërisë e cila i jep fleksibilitet administrimit të këtij fondi. Ky instrument i përdorur gjatë gjithë vitit ka siguruar në të njëjtën kohë të ardhura nga interesi. Niveli mesatar tremujor i depozitës gjatë administrimit vjetor të fondit ka qenë 81.5 milionë lekë ose 5.4% e fondit duke kontribuar edhe në ruajtjen e transhit të likuiditetit.

Në fillim të vitit 2020, Komiteti i Investimeve në përputhje dhe në zbatim të politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit, me qëllim ruajtjen e raporteve të transheve sipas monedhës vendosi që të konvertojë përpara arkëtimit të kontributit vjetor kundërvlerën e 200.000 eurove. Agjencia konvertoi 200.000 euro në muajin prill 2020. Portofoli në valutë arriti vlerën prej 1.000.000 eurosh, nga të cilat 800.000 euro janë investuar në muajin prill 2020 në obligacionin 2 vjeçar të emetuar nga Qeveria Shqiptare, ndërsa shuma prej 200.000 euro është mbajtur në llogari në gjendje cash pranë Bankës së Shqipërisë. Objektivat e caktuara në strategjinë e investimit për administrimin e këtij fondi në diversifikimin e tij sipas valutës janë realizuar që prej muajve të parë të vitit 2020 kjo për shkak të organizimit të ankandëve të paparashikuara të Qeverisë.

Gjendja e nënportofolit në euro në fund të vitit 2020 është në vlerën 124 milion e 669 mijë lekë pesha e të cilit kundrejt totalit të fondit është 6,26%. Nënportofoli në valutë është i investuar vetëm me valutën euro dhe përfshinë investime të bërë vetëm në tituj të Qeverisë Shqiptare të emetuara në euro.



Nënportofoli në lekë në fund të vitit 2020 është në vlerën 1,867 milion lekë dhe ka një peshe prej 93.7% kundrejt të gjithë vlerës së Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Investimet në monedhën vendase janë bërë duke pasur parasysh shpërndarjen sipas maturiteteve në një larmi datash me qëllim që të evitohen përqëndrime të larta të shumave në maturim. Gjatë vitit


2020 është investuar në tituj përkatësisht në muajt shkurt, mars, prill, qershor, korrik, shtator dhe nëntor. Për sa i përket afateve të maturimit gjatë vitit është investuar në tituj me afat maturimi 1, 2, 3 dhe 7 vjeçar, si dhe bono thesari me maturim 3 mujor.

Në muajin shkurt dhe maj është investuar me bono thesari me maturim 3 mujor përkatësisht në shumën 100 milion lekë dhe 290 milion lekë, ndërsa në muajin prill është bërë investimi në bono thesari me afat maturimi 12 mujor në shumën prej 150 milion lekë dhe në obligacione 2 vjeçare për shumën 800 mijë euro dhe 500 milion lekë. Në vijim, në muajin qershor është investuar në shumën 50 milion lekë obligacion me afat maturimi 3 vjeçar dhe në shumën 100 milion lekë obligacion me afat maturimi 7 vjeçar. Në muajin korrik vijoi investimi në shumën 150 milion lekë në obligacionin 2 vjeçar dhe në obligacionin 7 vjeçar investohet në muajin shtator në vlerën 50 milion lekë. Në muajin nëntor është investuar në bono thesari 3 mujore me shumë 246.65 milion lekë.


Të gjitha investimet e këtij fondi në nënportofolin në lekë janë në tituj të Qeverisë Shqiptarë dhe janë kryer në tregun primar.

Gjendja e depozitës në fund të vitit 2020 është në vlerën 395 mijë lekë. Vlera e likuiditetit të mbajtur në depozitë në fund të vitit krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020 ka ardhur në ulje graduale pasi është investuar më shumë në tituj duke garantuar kthim më të lart investimi.

Në grafikët në vijim paraqitet ndarja e mjeteve financiare të Fondit gjatë vitit 2020, sipas instrumenteve.



Për gjatë të gjithë vitit, Agjencia është kujdesur jo vetëm për një administrim sa më efektiv të fondit, por edhe duke pasur në vëmendje ruajtjen e raporteve sipas transeve dhe monedhës të përcaktuara në politikën dhe strategjinë e investimit. Vihet re se gjatë administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2020, në transhin e likuiditetit ka një rënie të mbajtjes së likuiditetit në depozitë dhe në llogari rrjedhëse krahasuar me fillimin e vitit ndërkaq ka një rritje të investimeve në obligacione dhe bono thesari.



Transhi i likuiditetit në fund të vitit ka vlerën 272.7 milion lekë dhe ka pësuar ulje me 55% në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2020 pasi ka një ulje të shumës së mbajtur në depozitën e hapur në Bankën e Shqipërisë, në llogari rrjedhëse dhe ulje të shumës së investuar në tituj me maturitet të mbetur deri në 3muaj.

Transhi i investimit në fund të vitit ka vlerën 1,718.9 milion lekë dhe ka pësuar një rritje prej 129% krahasuar me tremujorin e parë të vitit pasi janë rritur ndjeshëm si investimet me maturitet të mbetur deri në 2 vjet ashtu edhe investimet me maturitet të mbetur mbi 2 vjet.

Performanca e arritur nga administrimi i këtij fondi është e kënaqshme, ku norma vjetore e kthimit¹ për portofolin e investuar të FNJ në mbyllje të vitit financiar 2020 është 1.94% kundrejt 1.64% që llogaritej një vit më parë.

¹ E llogaritur si të ardhura nga interesat mbi portofolin nominal në fund të vitit pa përfshirë gjendjen në llogari rrjedhëse.